Shoqata Shqiptare e Furnizuesve të Energjisë Elektrike

Nr. 0611 Prot

Tiranë, më 06/11/2026

DREJTUAR: ENTI RREGULLATOR I ENERGJISE (ERE)
Z. PETRIT AHMETI
KRYETARI I BORDIT TË KOMISIONERËVE TË ERE

Lënda: Komentet e Shoqatës Shqiptare të Furnizuesve të Energjisë Elektrike (AAES) mbi projekt-rreguloren për "Për mënyrën e funksionimit të mjetit online të krahasimit të ofertave të furnizimit me energji elektrike"

I nderuar z. Ahmeti,

Shoqata Shqiptare e Furnizuesve të Energjisë Elektrike (AAES), në vijim të ftesës për konsultim, përcjellë nëpërmjet shkresës suaj nr. 2525/12 Prot., datë 21.10.2026, për paraqitjen e komenteve mbi projekt-rregulloren "Për mënyrën e funksionimit të mjetit online të krahasimit të ofertave të furnizimit me energji elektrike" (në vijim referuar si "Projekt-rregullorja"), dëshiron të shprehë vlerësimin e saj për nismën e ndërmarrë nga ERE në drejtim të rritjes së transparencës së tregut dhe lehtësimit të aksesit të konsumatorëve në informacionin mbi ofertat e furnizimit me energji elektrike.

AAES e vlerëson në tërësi pozitivisht përmbajtjen dhe objektivat e Projekt-rregullores, duke i konsideruar ato në përputhje me parimet e transparencës, konkurrencës dhe informimit të konsumatorëve, si dhe me praktikat e konsoliduara të tregjeve të energjisë elektrike.

Megjithatë, vlerësojmë se disa aspekte të parashikimeve rregullatore mund dhe duhet të qartësohen më tej, me qëllim garantimin e zbatueshmërisë praktike të tyre, shmangien e detyrimeve joproporcionale për furnizuesit dhe, mbi të gjitha, sigurimin që informacioni i publikuar në platformë të jetë real, i saktë dhe përfaqësues i ofertave faktikisht të disponueshme në treg.

Në këtë kuadër, paraqesim më poshtë komentet dhe propozimet e AAES:.

1. <u>Përcaktimi i qartë i subjekteve që i nënshtrohen detyrimit për publikim.</u>

AAES vlerëson se Projekt-rregullorja duhet të përcaktojë shprehimisht se detyrimi për publikimin e ofertave zbatohet vetëm ndaj furnizuesve të licencuar që ushtrojnë në mënyrë aktive veprimtari në tregun e furnizimit me pakicë të energjisë elektrike (retail).

Për këtë qëllim, propozojmë që si "furnizues aktiv" të konsiderohet çdo furnizues i licencuar që ushtron faktikisht veprimtari të furnizimit me energji elektrike ndaj klientëve fundorë, nëpërmjet lidhjes dhe zbatimit të marrëveshjeve kontraktuale të furnizimit, si dhe faturimit të energjisë elektrike të furnizuar.

Vetëm zotërimi i një licence për ushtrimin e veprimtarisë së furnizimit me energji elektrike nuk duhet të përbëjë, në vetvete, bazë për lindjen e detyrimit për publikimin e ofertave apo të informacionit mbi çmimet në platformë.

Për rrjedhojë, furnizuesit që nuk ushtrojnë aktualisht veprimtari në tregun e furnizimit me pakicë dhe që nuk kanë oferta tregtare faktikisht të disponueshme për klientët fundorë, nuk duhet t'i nënshtrohen detyrimit për publikim.

Zbatimi i një detyrimi të tillë edhe ndaj furnizuesve joaktivë do të krijonte nxitjen për hartimin dhe publikimin e ofertave formale, të cilat nuk pasqyrojnë produkte realisht të disponueshme në treg, vetëm me qëllim

përmbushjen e kërkesave rregullatore. Një praktikë e tillë do të cenonte besueshmërinë e platformës, duke krijuar konfuzion te konsumatorët dhe duke paraqitur një panoramë jo reale të ofertës tregtare në tregun e energjisë elektrike.

Gjithashtu, duhet mbajtur në konsideratë se transparenca e çmimeve përbën një instrument të rëndësishëm edhe për vetë furnizuesit, të cilët e përdorin informacionin e publikuar për të vlerësuar pozicionimin dhe konkurrueshmërinë e tyre në treg. Në këtë kuptim, publikimi i informacionit joreal ose i ofertave që nuk janë faktikisht të disponueshme do të ishte kundërproduktiv dhe në kundërshtim me vetë qëllimin e këtij instrumenti..

2. Përqendrimi i detyrimit për publikim te klientët familjarë dhe mikrondërmarrjet.

Duke iu referuar kuadrit rregullator të Bashkimit Evropian, në veçanti Direktivës (BE) 2019/944, Recitalit 35 dhe nenit 14, lidhur me instrumentet e pavarura të krahasimit dhe garantimin e aksesit në informacion të besueshëm, transparent dhe të krahasueshëm, AAES vlerëson se objektivi kryesor i platformës duhet të jetë lehtësimi i aksesit të klientëve familjarë dhe mikrondërmarrjeve në oferta standarde të furnizimit me energji elektrike.

Në këtë drejtim, vëmendje e veçantë duhet t'u kushtohet mikrondërmarrjeve me konsum vjetor të pritshëm nën 100,000 kWh, në përputhje me referencën përkatëse të kuadrit evropian.

Për rrjedhojë, konsiderojmë se edhe detyrimi për publikimin e ofertave dhe çmimeve duhet të orientohet t drejt këtyre kategorive të klientëve, duke garantuar që informacioni i paraqitur në platformë të jetë i standardizuar, lehtësisht i krahasueshëm dhe i dobishëm për vendimmarrjen e tyre.

Platforma mund të mundësojë gjithashtu përfshirjen e ofertave për kategori të tjera klientësh jofamiljarë. Megjithatë, marrëveshjet tregtare të negociuara individualisht ose të hartuara mbi bazën e kërkesave dhe nevojave specifike të klientit nuk duhet t'i nënshtrohen detyrimit për publikim.

Kjo për shkak se marrëveshje të tilla përmbajnë kushte të personalizuara tregtare dhe kontraktuale, të cilat nuk janë domosdoshmërisht të krahasueshme me ofertat standarde dhe as përfaqësuese të kushteve të përgjithshme të tregut.

3. Statusi aktual i tregut.

Bazuar në informacionin që disponon AAES, aktualisht vetëm një numër relativisht i kufizuar klientësh të furnizuar nga furnizuesit privatë kanë një konsum vjetor nën 100,000 kWh.

Në këto kushte, aktiviteti i furnizuesve aktivë në tregun e furnizimit me pakicë është përqendruar kryesisht te klientët me konsum të mesëm dhe të lartë, ndërsa, sipas informacionit të disponueshëm për Shoqatën, një pjesë dërrmuese e marrëdhënieve kontraktuale të furnizimit janë realizuar nëpërmjet negociatave të drejtpërdrejta ndërmjet palëve.

Ky realitet i tregut duhet të merret në konsideratë gjatë hartimit të dispozitave për publikimin e ofertave, në mënyrë që kërkesat rregullatore të jenë proporcionale dhe të zbatueshme në praktikë.

Në këtë kuadër, AAES thekson se ofertat e publikuara duhet të pasqyrojnë në mënyrë besnike ofertën reale tregtare të furnizuesit, si dhe kapacitetin dhe vullnetin e tij faktik për të furnizuar klientët sipas kushteve të përcaktuara në ofertë.

SHOQATA SHQIPTARE E FURNIZUESVE TE ENERGJISE ELEKTRIKE
AAES Albanian Association of Electricity Suppliers

Vendosja e detyrimit për publikimin e çmimeve edhe ndaj furnizuesve që nuk janë aktivë në tregun e furnizimit me pakicë, apo që nuk ofrojnë produkte për kategoritë e klientëve familjarë dhe mikrondërmarrjeve, do të rrezikonte krijimin e një baze informacioni çorientuese dhe jopërfaqësuese për tregun.

Një situatë e tillë do të sillte konfuzion te konsumatorët dhe do të cenonte drejtpërdrejt qëllimin e platformës, i cili duhet të jetë ofrimi i një pasqyre të saktë, transparente dhe të besueshme të ofertave që janë realisht të disponueshme në treg.

Për sa më sipër, vlerësojmë se Projekt-rregullorja duhet të garantojë një lidhje të drejtpërdrejtë ndërmjet detyrimit për publikim, aktivitetit faktik të furnizuesit në tregun e shitjes me pakicë dhe disponueshmërisë reale të produkteve për kategoritë përkatëse të klientëve

4. Saktësia e informacionit, përditësimi dhe kufijtë e përgjegjësisë së furnizuesit

AAES vlerëson se përgjegjësia e furnizuesve për saktësinë, plotësinë dhe përditësimin e informacionit të publikuar në platformë duhet të kufizohet në të dhënat që ndodhen nën kontrollin e tyre të drejtpërdrejtë ose të arsyeshëm.

Në këtë drejtim, afati prej 72 orësh i parashikuar për korrigjimin e informacionit duhet të përcaktohet në mënyrë të qartë dhe të paekuivok, duke specifikuar momentin nga i cili fillon llogaritja e këtij afati, mënyrën e njoftimit të furnizuesit dhe procedurën konkrete për kryerjen e korrigjimeve.

Gjithashtu, duhet të parashikohet shprehimisht se furnizuesit nuk mund të mbajnë përgjegjësi për pasaktësi, vonesa apo mospërputhje që vijnë si rezultat i defekteve teknike të platformës, gabimeve gjatë transmetimit ose përpunimit të të dhënave, si dhe problematikave që lidhen me sisteme apo infrastruktura të jashtme, të cilat nuk janë nën kontrollin e tyre.

Një përcaktim i tillë do të garantonte ndarjen e qartë të përgjegjësive ndërmjet furnizuesve dhe administratorit të platformës, duke shmangur vendosjen e barrës së përgjegjësisë mbi subjektet për rrethana që nuk varen prej tyre.

Në përfundim të sa më sipër, AAES propozon që Projekt-rregullorja të rishikohet duke reflektuar parimet dhe ndryshimet konkrete të mëposhtme

1) Publikimi i detyrueshëm të përfshijë vetëm ofertat standarde të furnizimit me energji elektrike, të cilat janë realisht të disponueshme në treg për klientët familjarë dhe mikrondërmarrjet me konsum vjetor të pritshëm nën 100,000 kWh.

2) Detyrimi për publikimin e ofertave të furnizimit me energji elektrike të zbatohet vetëm ndaj furnizuesve të licencuar që ushtrojnë në mënyrë aktive veprimtari në tregun e furnizimit me pakicë.

   Për të garantuar qartësi dhe siguri juridike në zbatimin e këtij detyrimi, propozojmë që ERE të parashikojë një mekanizëm sipas të cilit furnizuesit që nuk janë aktivë në momentin e hyrjes në fuqi të Rregullores, të detyrohen të publikojnë ofertat e tyre brenda një afati prej 3 (tri) ditësh nga fillimi faktik i aktivitetit të furnizimit me pakicë, edhe në rastin kur ky aktivitet fillon me furnizimin e vetëm një klienti.

   Ky mekanizëm do të shmangte paqartësitë lidhur me klasifikimin e furnizuesve si aktivë ose joaktivë dhe do të siguronte zbatimin e detyrimit për publikim në momentin kur lind realisht aktiviteti tregtar përkatës.

Gjithashtu, theksojmë se transparenca e çmimeve dhe publikimi i ofertave janë në interes të vetë furnizuesve që synojnë të hyjnë ose të zgjerohen në tregun e furnizimit me pakicë, duke kontribuar në rritjen e konkurrencës dhe të transparencës së përgjithshme të tregut.

3) Të parashikohet shprehimisht përjashtimi nga detyrimi për publikim i marrëveshjeve të furnizimit të negociuara individualisht ndërmjet furnizuesit dhe klientit, si dhe i marrëveshjeve të hartuara mbi bazën e kërkesave specifike të klientëve, të cilat përmbajnë kushte të personalizuara tregtare dhe kontraktuale.

4) Të qartësohen përgjegjësitë e furnizuesve dhe administratorit të platformës për saktësinë dhe përditësimin e informacionit, si dhe të përcaktohet në mënyrë të detajuar procedura dhe afati 72-orësh për korrigjimin e të dhënave, duke përjashtuar përgjegjësinë e furnizuesve për problematika teknike ose pasaktësi që nuk janë nën kontrollin e tyre.

Në përfundim, AAES rithekson mbështetjen e saj për nismën e ERE-s për krijimin dhe funksionimin e një mjeti online për krahasimin e ofertave të furnizimit me energji elektrike, duke e konsideruar atë një instrument të rëndësishëm për rritjen e transparencës dhe zhvillimin e konkurrencës në treg.

Njëkohësisht, vlerësojmë se efektiviteti i kësaj platforme do të varet në mënyrë të drejtpërdrejtë nga cilësia, saktësia dhe përfaqësueshmëria e informacionit të publikuar. Për këtë arsye, është thelbësore që detyrimet e parashikuara në Projekt-rregullore të jenë proporcionale, të qarta dhe të lidhura me aktivitetin real të furnizuesve dhe ofertat faktikisht të disponueshme për klientët.

Në këtë frymë, kërkojmë që komentet dhe propozimet e mësipërme të merren në konsideratë gjatë finalizimit dhe miratimit të Projekt-rregullores.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin dhe për mundësinë e dhënë për të kontribuar në këtë proces konsultimi, mbetemi të gatshëm për të ofruar çdo sqarim apo kontribut të mëtejshëm që mund të konsiderohet i nevojshëm.

Lutemi marrjen në konsideratë të kërkesave tona.

Ju falenderojmë paraprakisht.

Me respekt,

SHOQATA SHQIPTARE E FURNIZUESVE TË ENERGJISË ELEKTRIKE
(AAES)

SHOQATA SHQIPTARE E FURNIZUESVE TE ENERGJISE ELEKTRIKE
AAES Albanian Association of Electricity Suppliers

KRYETARI
Olsi TURABI